

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE  
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 225/19  
 Broj Prot. 225/19  
 Datum: 19.04.19  
 Data: 19.04.19

Nr. i Faqeve 2  
 Broj Stranica 2  
 No. Pages 2

KM-MIT  
 PRISHTINE/A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE  
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 4165  
 Broj Prot. 4165  
 Datum: 19.04.19  
 Data: 19.04.19

01  
 01

PRISHTINE/A

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria -Vlada-Government  
 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit  
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta  
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

## VENDIM

**I. Aprovohet** kërkesa nr.2166 e Operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus N.T. "Atmaxha Trans" me seli në Prizren për marrjen e nisjeve në relacionin Prizren-Suhareke - Prishtine dhe anasjelltas me oraret e nisjeve (19:15 - 21:00; 19:45 - 06:30).

### *Arsyetim*

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus N.T. "Atmaxha Trans" me seli në Prizren **ka plotësuar** kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për

marrjen e nisjeve ne relacionin Prizren-Suhareke - Prishtine dhe anasjelltas me oraret e nisjeve (19:15 - 21:00; 19:45 - 06:30).

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

#### **Këshilla Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrijë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

**Pal LEKAJ**

Ministër



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.